



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 15, Datë 06.02.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ARÇOVA”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.02.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 242/1 prot., datë 31.01.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Arçova”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 242 prot., datë 25.01.2024, ka paraqitur aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Arçova”, me kapacitet prodhues 1.26 MW, në Përroin e Arçorvës, Degë e përroit të Seltës dhe Holtës, me derdhje në lumin Shkumbin, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “GEALB ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”;

për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” si dhe për pikën 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të sqarohet/dokumentohet informacion shtesë për dokumentacionin si vijon:
 - Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse në Shtojcën 2, përse i përket kapacitetit të instaluar, pasi nga sa plotësuar nga vetë shoqëria rezulton 1.26 MW, jo i njëjtë me kapacitetin që rezulton nga kontrata me MIE apo lejet që disponon, prej 1.28 MW.
 - Nevojitet informacion shtesë në lidhje me VNM aktuale, e cila është e vlefshme, por në kuptim të parashikimeve të shoqërisë për të filluar ndërtimin e HEC-it në datë 01.02.2024 si dhe në kuadër të vlefshmërisë së kësaj së fundit, vlerësohet t’i kërkohej informacion në lidhje me fazën ku ndodhet me fillimin e punimeve.
 - Shoqëria rezulton se ka përcjellë dokumentacionin i cili vërteton mbulimin nga ana financiare të vlerës totale të investimit. Në vijim do t’i kërkohej të cilësojë nëse balancat aktive që zotëron në bankën “Raiffeisen Bank” sh.a., janë të dedikuara për veprimtarinë e prodhimit, veprimtari për të cilën kërkon të licencohet pranë ERE-s.
 - Subjekti disponon leje të vlefshme të përdorimit të burimit ujor, pasi leja aktuale mban datën 22.11.2023 dhe është e vlefshme për 5-vjet. Si e tillë edhe vendimi përfundimtar në rastin e licencimit do të ketë referencat sipas kushteve të që i përmbahen afateve të lejes së përdorimit të burimit ujor apo rinovimit të saj brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Arçova”, me kapacitet të instaluar 1.28 MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI